

Koordinatorë të Projektit EduGame zhvillojnë një takim me personelin akademik të Fakultetit të Biznesit e Drejtësisë

Në Fakultetin e Biznesit dhe i Drejtësisë, në kuadër të vizitës zyrtare të përfaqësuesve nga Universiteti i Vytautas Magnus, Lituani, koordinator i projektit EduGame, u zhvillua një takim me personelin akademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Gjatë takimit, përfaqësuesit Doc. Dr. Judita Kasperuniene dhe Dr. Dovile Kuiziniene, prezantuan universitetin e tyre dhe ndanë përvojat në zhvillimin e metodave inovative mësimore.

U diskutua gjithashtu për mundësi bashkëpunimi në projekte të përbashkëta, programe të dyfishta, shkëmbime studentësh dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare. U theksua rëndësia e forcimit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe e rritjes së kapaciteteve akademike të studentëve dhe stafit, ndërsa takimi shërbeu si një mundësi e vlefshme për të planifikuar hapat e ardhshëm të bashkëpunimit.

